**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË**
**DEGA VENDORE TIRANË**
**NOTER JULIAN ZHELEGU**

**DATE 10/02/2022**
**NR REP 1239**

PULLE TARIFE 200 LEKE R.SHQIPERISE

72022053950093168992

**VËRTETIM NJËSIE ME ORIGJINALIN**

Sot, më datë 10/02/2022, para meje Noterit JULIAN ZHELEGU, Anëtar në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Njesia Bashkiake nr. 5, Rr. Pjeter Bogdani, Godina Nr. 13, Hyrja Nr. 2, u paraqit personalisht:

**KËRKUES/IT**:
**Diora Shino**, atësia Hyqmet, amësia Gjinovefa, shtetase Shqiptare, lindur në Fier dhe banues në TIRANË, me adresë Blv. Zhanë D'ark; Nd. 131; H. 4; Ap. 18; Njësia Administrative Nr. 3; Njësia Bashkiake Nr. 3; 1005; Tiranë, lindur më 17/12/1982, gjendja civile "e martuar", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 035201132 dhe nr. personal I26217109M,

e cila me kerkoi te vertetoj dokumentin e njejte me origjinalin: ***Kontrate shitje pasuri e luajtshme me nr.rep:9473, nr.kol:3091, me date 09.11.2021 bashkelidhur vendimi me nr.28, me date 25.10.2021.***

Unë Noteri, pasi i bëra të qartë personit të mësipërm, përgjegjësinë penale në rast paraqitje të dokumenti të rremë; bëra krahasimin e përmbajtjes së dokumentit origjinal me fotokopjen e paraqitur, mbi të cilat më rezulton se nuk janë bërë korrigjime, shtesa, fshirje, a shenja të tjera të dyshimta.

Si rrjedhim, në bazë të nenit 62, shkronja "i", nenit 129 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë"; Vërtetoj se fotokopja e dokumentit të paraqitur nga kërkuesi para meje Noterit, është e njëjtë me dokumentin origjinal.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë Noteri deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të kërkuesit të këtij dokumenti, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

**NOTER**

JULIAN ZHELEGU

NOTER
TIRANË

DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
NATIONAL CHAMBER OF NOTARIES
TIRANË SHQIPËRI TIRANA ALBANIA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
JULIAN XH. ZHELEGU
NOTER
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË

DEGA VENDORE TIRANË

NOTER JULIAN ZHELEGU
ADRESA Njesia Bashkiake nr. 5, Rr. Pjeter Bogdani, Godina Nr. 13, Hyrja Nr. 2
TEL: 0682027818

# KONTRATË SHITJE PASURI E LUAJTSHME

(KUOTA KAPITALI)

**Nr. repertori: 9473** **Nr. koleksioni: 3091**

**Tirane më 09/11/2021**

Ligjet referuese:

1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar

2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar

3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"

A2021053950334979829

MARKA E PULLES
U PAGUA

A2021053950334979829

# KONTRATË SHIT BLERJE KUOTASH ME KUSHT

Ne Tirane, sot me date 9 / 11 / 2021 (dy mije e njëzet e një), para meje Julian Zhelegu, Noter i Dhomës se Noterëve Tirane, me zyre ne adresën Rr. Pjetër Bogdani, nr. 13, u paraqiten:

**Shitësi**
Shoqeria **"ERNIKU" shpk**, shoqeri e se drejtes shqiptare, e regjistruar rregullisht prane Qendres Kombetare te Biznesit, me NUIS J71925004S, me zyre qendrore Tirane Sheshi Rilindja, Qendra e Biznesit Karl Topia, Kulla Nr.3, Kati i Trete, përfaqësuar nga administratori, njëkohësisht ortaku i vetëm, Iljaz Spahiu, lindur me date05.07.1969 ne Kolesjan,Kukes mbajtes i letërnjoftimit me numër 034191858 dhe numër personal G90705104H , madhor dhe me zotësi juridike për te vepruar,

këtu e më poshtë referuar ne këtë kontratë si **Shitësi**

*dhe*

**Blerësi**
Shoqëria **"AG Hpower & Construction" Shpk**, shoqëri e së drejtës shqiptare, e regjistruar rregullisht pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, mbajtëse e NUIS L91924026B, me seli në, Fier Lagja Sheq i Madh, Rruga Nacionale Fier - Tirane, pranë Urës së Mbrostarit, e përfaqësuar sipas vendimit te Asamblesë se Ortakëve nr. 07, date 25.10.2021, nga Administratori i Shoqërisë Z. Zeni Tërpollari, lindur me date 13/08/1984 ne Çorovode,Skrapar mbajtes i letërnjoftimit me numër 035364689 dhe numër personal I40813012F , madhor dhe me zotësi juridike për te vepruar,

këtu e më poshtë referuar ne këtë kontratë si **Blerësi**,

*dhe*

**Miratuesi**
Shoqëria **"SA- GLE KOMPANI" Shpk**, shoqëri e së drejtës shqiptare, e regjistruar rregullisht pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, mbajtëse e NUIS K92227019N, me seli në, Tiranë në adresën: "Sheshi Rilindja, Qendra e Biznesit "Karl Topia", Kulla 3, Kati 3, e përfaqësuar sipas vendimit te Asamblesë se Ortakëve nr. 12, date 25.10.2021, nga Administratori i Shoqërisë Znj. Vera Spahiu, lindur me date25.06.1974 ne Kruje mbajtëse e letërnjoftimit me numër 036052618 dhe numër personal H45625092N, madhore dhe me zotësi juridike për te vepruar,

këtu e më poshtë referuar ne këtë kontratë si **Miratuesi**,

**Parashtresa:**

A. Shoqëria "ERNIKU" Shpk. është ortak i vetëm i Shoqërisë "SA- GLE KOMPANI" shpk, shoqëri tregtare e së drejtës shqiptare, e regjistruar në QKB me NUIS K92227019N dhe zotëron 100% të kapitalit të shoqërisë "SA- GLE KOMPANI" shpk.

B. Shoqeria "SA- GLE KOMPANI" shpk ka objekt te aktivitetit te saj Ndertimi, operimi, financimi,venia ne pune, prodhimi furnizimi, transmetimi, shperndarja, eksportimi, shitja e energjise elektrike dhe transferim i hidrocentraleve ne zbatim te kontrates se

A2021053950334979829

koncensionit date 14.09.2009 me Nr. 2901 Rep Nr. 395 Kol ndermjet Autoritetit Kontraktues Ministrise se Ekonomise, Tregtise dhe Energjitikes dhe shoqerise Koncesionare "Erniku" shpk. "Per ndertimin e hidrocantraleve ne rrjedhen e perroit Trebisht-Rrethi Bulqize.

C. Bazuar ne parashikimet e kesaj kontrate do te merret marre miratimi prane Ministrise se Infrastruktures dhe Energjise per trasferimin nepermjet shitblerjes te 100 % te kuotave qe shoqeria ERNIKU shpk, zoteron ne shoqerine SA- GLE KOMPANI" shpk ne favor te shoqerise "AG Hpower & Construction" shpk duke rezultuar ortak i vetem i shoqerise "SA- GLE KOMPANI" shpk, shoqeria AG Hpower & Construction" Shpk.

D. Shoqeria "SA- GLE KOMPANI" shpk eshte liçencuar per prodhimin e energjise elektrike me numer liçence 180 leshuar nga Enti Rregullator i Energjise per shoqerine SA-GLE KOMPANI shpk me afat liçence per nje periudhe prej 30 vitesh.

E. HEC-et ne rrjedhen e perroit Trebisht-Rrethi Bulqize shtrihen mbi pasurite sipas vërtetimit leshuar ne vitin 2010 nga Zyra Vendore e Regjistrimit te Pasurive te Paluajtshme Bulqize bashkelidhur kesaj kontrate ne perdorim te Erniku shpk dhe ne pasurite e tjera ne pronesi te Erniku shpk.

F. Shitësi dëshiron që të shesë 100% te kuotave qe zotëruara në shoqërinë "SA- GLE KOMPANI" shpk, sipas kushteve dhe termave te percaktuara ne kete kontrate si me poshte.

G. Blerësi dëshiron që të blejë 100% te kuotave të shoqërisë "SA- GLE KOMPANI" shpk, te zoteruara nga shoqeria ERNIKU shpk sipas kushteve dhe termave te percaktuara ne kete kontrate si me poshte.

H. Miratuesi i shitblerjes jep pelqimin/miratimin per shitblerjen e 100% te kuotave te shoqerise "SA- GLE KOMPANI" shpk sipas kushteve dhe termave te percaktuara ne kete kontrate si me poshte.

I. Ne kuotat e shoqerive ERNIKU shpk dhe SA- GLE KOMPANI" shpk jane vendosur sekuestro konservative sipas Aneks A bashkelidhur kesaj kontrate.

J. Gjendja financiare e shoqerise Shoqerise SA- GLE KOMPANI" shpk eshte sipas Raport Vleresimit pasqyrat financiare/rakordimet financiare si Aneksi B bashkelidhur kesaj kontrate.

Palët e sipërpërmendura me vullnetin e tyre të lirë e të plotë ranë dakord si më poshtë:

**Neni 1**
**Qëllimi i Kontratës**

Qëllimi i kësaj kontrate është transferimi i pronësisë së 100% te kuotave te shoqerise "SA- GLE KOMPANI" shpk te zoteruara nga Shitësi ERNIKU shpk tek Blerësi, shoqëria "AG Hpower & Construction" Shpk.
Kjo kontratë shërben për përcaktimin e kritereve, procedurave dhe mënyrës së transferimit të pronësisë dhe pagesës lidhur me këtë transferim.

A2021053950334979829

Trasferimi i kuotave perfshin trasferimin e te gjitha te drejtat dhe detyrimet sipas kontrates se koncensionit date 14.09.2009 me Nr. 2901 Rep Nr. 395 Kol ndermjet Autoritetit Kontraktues Ministrise se Ekonomise, Tregtise dhe Energjitikes dhe shoqerise Koncesionare "Erniku" shpk "Per ndertimin e hidrocantraleve ne rrjedhen e perroit Trebisht-Rrethi Bulqize dhe shtojcave eventuale te kesaj kontrate dhe asetet HEC.

**Neni 2**
**Objekti i kontratës**

Nëpërmjet kësaj kontrate, shitësi do të transferojë pronësinë e 100% te kuotave te shoqerise "SA- GLE KOMPANI" shpk. ne favor te "AG Hpower & Construction" shpk kundrejt pageses se çmimit te shitblerjes siç përcaktohet ne nenin 3 te kesaj kontrate.

**Neni 3**
**Çmimi dhe mënyra e pagesës - Kushti**

Palët kanë rënë dakort midis tyre që çmimi i shitjes së kuotave eshte ne vleren 50.000 euro. Çmimi i shitjes do të paguhet përmes transfertës bankare nga llogaria e shitësit në llogarinë e blerësit Nr. ____________ ne Credins Bank sha brenda 3 muajve nga data e nenshkrimit te kesaj kontrate, afat brenda te cilit shoqerite Erniku shpk dhe SA- GLE KOMPANI shpk duhet te heqin te gjitha sekuestrot dhe kufizimet qe rezultojne ne ekstraktet sipas Aneks A bashkelidhur kesaj kontrate. Ne rast se brenda 3 muajve nga data e nenshkrimit te kesaj kontrate, nuk jane hequr sekuestrot sipas Aneks A, ose brenda ketij afati jane hequr sekuestrot por nuk eshte bere pagesa e çmimit te shitblerjes, kontrata konsiderohet e zgjidhur dhe palet kthehen ne gjendjen e meparshme.
Çmimi i shitjes prej 50.000 euro do të konsiderohet i likuiduar në momentin kur vlera të ketë mbërritur në llogarinë e shitësit. Brenda 5 ditëve pune nga pagesa e çmimit te shitblerjes, shoqeria **ERNIKU" shpk**, përfaqësuar nga administratori, njëkohësisht ortaku i vetëm, Iljaz Spahiu detyrohet të bëjë regjistrimin e kësaj kontratë në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

**Neni 4**
**Përgjegjësitë dhe garancitë e palëve**

A. **Shoqeria "ERNIKU" Shpk garanton se:**

1. Nepemjet huas qe do te marrë shoqeria SA-GLE KOMPANI shpk nga shoqeria "AG Hpower & Construction" Shpk do te realizoje te gjitha pagesat e nevojshme me qellim heqjen e sekuestrove ne kuotat e shoqerive "ERNIKU" Shpk dhe SA- GLE KOMPANI" shpk qe te vijohet me regjistrimin ne QKB te kesaj kontrate.
2. Vendimi per transferimin e kuotave te Blerësi është marrë në pajtim të plotë me ligjin tregtar në fuqi dhe dispozitat statutore të shoqërive.
3. Shoqerite ERNIKU Shpk dhe SA- GLE KOMPANI shpk nuk kane detyrime te tjera ndaj te treteve perveç sa parashikuar ne Raport Vleresimin/Pasqyrat Financiare/Rakordimet Financiare bashkelidhur kesaj kontrate si Aneks B dhe ne ekstraktet e shoqerive ERNIKU Shpk dhe SA- GLE KOMPANI" shpk sipas Aneks A.
4. Shoqerite ERNIKU Shpk dhe SA- GLE KOMPANI shpk nuk do te ndermarrin persiper asnje detyrim/angazhim apo te kryejne çfaredo transaksioni me kuota te shoqerive dhe/ose pasuri te ketyre shoqerive perveç sa referuar ne kete kontrate, duke filluar nga momenti i nenshkrimit te kesaj kontrate dhe deri kur shoqeria "AG Hpower & Construction" Shpk te

A2021053950334979829

rezultojë ortak me 100% te kuotave te shoqerise "SA- GLE KOMPANI" shpk ne ekstraktin e shoqerise.

5. Çdo detyrim i gjeneruar apo transaksion qe nuk eshte parashikuar ne kete kontrate i kryer pas dates se nenshkrimit te kesaj kontrate apo edhe detyrime dhe transaksione te tjera te cilat jane gjeneruar perpara dates se nenshkrimit te kesaj kontrate qe nuk jane perfshire ne Anekset A dhe B bashkelidhur kesaj kontrate do te shlyhen teresisht nga ERNIKU shpk dhe ERNIKU shpk mban pergjegjesi te plote per t`i shlyer keto detyrime dhe te marre pergjegjesite e transaksioneve te kryera. Ne rast se perben domosdoshmeri kryerja e ndonje transaksioni tjeter/ndryshe nga sa parashikuar ne kete kontrate, nga shoqeria ERNIKU Shpk dhe SA- GLE KOMPANI shpk duhet qe per kete transaksion te marre paraprakisht miratimin me shkrim te shoqerise AG Hpower & Construction shpk.
6. Çdo pretendim eventual nga pale te treta ne lidhje me transaksione te kryera nga ERNIKU Shpk dhe/ose SA- GLE KOMPANI shpk qe jane raportuar/pasqyruar ne Aneks B nga shoqerite ERNIKU Shpk dhe/ose SA- GLE KOMPANI shpk si "te shlyera/te mbyllura" apo pretendime te tjera tej sa raportuar/pasqyruar ne Aneks A dhe Aneks B te do te perballohen nga ERNIKU shpk dhe shoqeria ERNIKU Shpk nuk do tà perfshij shoqerine AG Hpower & Construction" Shpk ne keto pretendim.
7. Me trasferimin e kuotave, shoqerise AG Hpower & Construction" Shpk i trasferohen te gjitha te drejtat dhe detyrimet sipas kontrates se koncensionit date 14.09.2009 me Nr. 2901 Rep Nr. 395 Kol ndermjet Autoritetit Kontraktues Ministrise se Ekonomise, Tregtise dhe Energjitikes dhe shoqerise Koncesionare "Erniku" shpk. "Per ndertimin e hidrocantraleve ne rrjedhen e perroit Trebisht-Rrethi Bulqize dhe shtojcave eventuale te kesaj kontrate dhe asetet HEC.
8. Shoqeria ERNIKU shpk si pronar i pasurive nr. 391, nr. 307, nr. 309, nr. 124, nr. 145 dhe nr. nr. 299, nr. 442 detyrohet te nenshkruaje kontraten e shitblerjes se ketyre pasurive me bleres "AG Hpower & Construction" Shpk apo eventualisht edhe per pasuri te tjera ne pronesi te tij ku shtrihet HEC.

**B. Shoqeria "AG Hpower & Construction" shpk garanton se:**

1. Do te kryeje te gjitha pagesat sipas nenit 3 per kalimin e pronesise se kuotave. Ne rast se nuk kryhet kjo pagese konform siç parashikuar ne kete nen, kontrata do te konsiderohet e zgjidhur dhe palet kthehen ne gjendjen e meparshme.

**C. Shoqeria "SA- GLE KOMPANI" shpk garanton se:**

1. Shoqeria SA- GLE KOMPANI shpk nuk ka detyrime te tjera ndaj te treteve perveç sa parashikuar ne Raport Vleresimin/pasqyrat financiare/rakordimet financiare bashkelidhur kesaj kontrate si Aneks B dhe ne ekstraktet e shoqerive ERNIKU Shpk dhe SA- GLE KOMPANI" shpk sipas Aneks A.
2. Shoqeria SA- GLE KOMPANI shpk nuk do te ndermarr persiper asnje detyrim/angazhim apo te kryej çfaredo transaksioni me kuota te shoqerise dhe/ose pasuri te shoqerise perveç sa referuar ne kete kontrate, duke filluar nga momenti i nenshkrimit te kesaj kontrate dhe deri kur shoqeria AG Hpower & Construction" Shpk te rezultoi ortak me 100% te kuotave te shoqerise SA- GLE KOMPANI shpk.
3. Çdo detyrim i gjeneruar apo transaksion tjeter i kryer pas dates se nenshkrimit te kesaj kontrate apo edhe detyrime dhe transaksione te tjera te cilat jane gjeneruar perpara dates se nenshkrimit te kesaj kontrate qe nuk jane perfshire ne Aneks B dhe/ose ne Aneks A bashkelidhur kesaj kontrate do te shlyhen teresisht nga SA- GLE KOMPANI" shpk dhe

SA- GLE KOMPANI shpk mban pergjegjesi te plote per ti shlyer keto detyrime dhe te marre pergjegjesite e transaksioneve te kryera. Ne rast se perben domosdoshmeri kryerja e ndonje transaksioni tjeter/ndryshe nga sa parashikuar ne kete kontrate nga shoqeria SA- GLE KOMPANI shpk duhet qe per kete transaksion te marre paraprakisht miratimin me shkrim te shoqerise AG Hpower & Construction shpk.

4. Çdo pretendim eventual nga pale te treta ne lidhje me transaksione te kryera nga SA- GLE KOMPANI shpk qe jane raportuar/pasqyruar ne Aneks B nga shoqerite ERNIKU Shpk dhe/ose SA- GLE KOMPANI shpk si "te shlyera/te mbyllura" apo pretendime te tjera tej sa raportuar/pasqyruar ne Aneks A dhe Aneks B do te perballohen nga ERNIKU shpk dhe shoqeria ERNIKU Shpk nuk do tà perfshij shoqerine AG Hpower & Construction" Shpk ne keto pretendim.
5. Me trasferimin e kuotave, shoqerise AG Hpower & Construction" Shpk i trasferohen te gjitha te drejtat dhe detyrimet sipas kontrates se koncensionit date 14.09.2009 me Nr. 2901 Rep Nr. 395 Kol ndermjet Autoritetit Kontraktues Ministrise se Ekonomise, Tregtise dhe Energjitikes dhe shoqerise Koncesionare "Erniku" shpk. "Per ndertimin e hidrocantraleve ne rrjedhen e perroit Trebisht-Rrethi Bulqize dhe shtojcave eventuale te kesaj kontrate dhe asetet HEC.
6. Nuk ka kundershtime, eshte dakort dhe autorizon shoqerine ERNIKU shpk ne menyre te parevokueshme qe te vijoj me shlyerjen e pagesave perkatese per te mbyllur detyrime te shoqerise SA- GLE KOMPANI" shpk.
7. Eshte dakort qe pasurite nr. 391, nr. 307, nr. 309, nr. 124, nr. 145 dhe nr. nr. 299, nr. 442 si pasuri ne te cilat shtrihet HEC apo eventualisht edhe per pasuri te tjera ne pronesi te ERNIKU shpk dhe/ose SA- GLE KOMPANI" shpk. ku shtrihet HEC te vijohet me shitblerjen e ketyre pasurive me bleres "AG Hpower & Construction" Shpk.

**8.**

## Neni 5
## Efektet e kontratës

Kjo kontratë ka fuqinë e ligjit për palët nga momenti i nënshkrimit të saj dhe mund të ndryshohet vetëm me marrëveshje me shkrim midis tyre.

## Neni 6
## Informacioni konfidencial

Palët detyrohen të mbajnë konfidencial të gjithë dokumentacionin të dhënat dhe cdo informacion të përfituar gjatë marrëdhënies së tyre në shoqëri apo dhe referuar marrdhënies konkrete të krijuar me këtë kontratë.

## Neni 7
## Transferimi të drejtave

Kontrata do të depozitohet dhe regjistrohet pranë QKB siç parashikuar ne nenin 3 te kësaj kontrate, për të bërë të mundur regjistrimin e transferimit të kuotave tek Blerësi.

## Neni 8
## Ligji i aplikueshëm dhe Gjykata kompetente

Kontrata është hartuar në përputhje me legjislacionin tregtar në fuqi.
Shitësi dhe Blerësi angazhohen që të bëjnë cdo përpjekje për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve apo konflikte të mundshme që mund të krijohen midis tyre lidhur me këtë kontratë, nëpërmjet bisedimeve të drejtpërdrejta.

A2021053950334979829

Nëse palët dështojnë në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve apo konflikteve midis tyre, çështja do të zgjidhet nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tirane.

**Neni 9**
**Dispozita përfundimtare**

Kjo kontratë është hartuar në katër kopje, në gjuhën shqipe, secila me vlerë të njejtë ligjore. Bashkelidhur kesaj kontrate vendosen vendimarrjet e Asamblese se Ortakeve te shoqerive nenshkruese te kesaj kontrate me vertetim nenshkrimi te noterit, percaktimi i sekuestrove te shoqerive ERNIKU Shpk dhe SA- GLE KOMPANI shpk si Aneks A dhe Raporti Vleresimit/pasqyrat financiare/rakordimet financiare si Aneks B dhe dokumentet e identifikimit te përfaqësuesve te paleve nenshkruese te kontrates.
Kesaj kontrate do t`i bashkelidhen edhe mandatet bankare te kryerjes se pagesave nga ana e bleresit ne favor te shitesit.

Kontrata u redaktua nga unë noteri sipas kërkesës se palëve ne gjuhen shqipe dhe ne 4 kopje origjinale, dhe pasi iu lexua dhe iu shpjegua palëve nga unë noteri me zë te larte dhe te qarte u kuptua dhe u pranua prej palëve, u nënshkrua rregullisht dhe pa vërejtje prej palëve ne praninë time dhe unë, noteri, e vërtetoj sipas ligjit dhe për te gjithë efektet e tij.

**SHITËSI:**

**Shoqëria: "ERNIKU" Shpk**

**Z. ILJAZ SPAHIU**

**BLERËSI:**

**Shoqëria: "AG Hpower & Construction" Sh.p.k**

**Z. ZENI TËRPOLLARI**

**MIRATUESI**

**Shoqëria: "SA- GLE KOMPANI" Shpk**

**Znj. VERA SPAHIU**

**NOTER**
**Julian Zhelegu**

ERNIKU

Shoqeria "ERNIKU" sh.p.k
Adresa Sheshi Rilindja,
Qendra e biznesit Karl Topia, Tirane
Tel & Fax +355 4 240 36 31
Mob. +355682023775
E-mail: erniku@erniku.com
Web: http://www.erniku.com

Tiranë, më 25 / 10 /2021

VENDIM Nr. 28
I Ortakeve të Shoqërisë "ERNIKU" Shpk.

Ky vendim i mare sot më datë 25 / 10 /2021 në selinë e Shoqërisë "ERNIKU" Shpk, Adresa: Sheshi "Rilindja", Qendra e Biznesit "Karl Topia",Kulla Nr.3, Kati III, Tiranë, regjistruar ne QKB me NIPT J71925004S ne mblodhjen e Asamblese se Zakonshme e Ortakve te shoqerise.

Në bazë të ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe shoqëritë tregtare", dhe në bazë të Statutit të Shoqërisë, ortaku i shoqërisë thirri Asamblene e Ortakeve me këtë rend dite:

Rendi i ditës:

- Shoqërisë "ERNIKU" Sh.p.k me ortak te vetem Z.Iljaz SPAHIU, zoterus i 100 % te aksioneve te saje.
- Shoqërisë "ERNIKU" Sh.p.k eshte ortak i vetem zoterus i 100 % te aksioneve te Shoqërisë Koncesionare "SA-GLE KOMPANI" Sh.p.k.

Shoqërisë "ERNIKU" Sh.p.k kerkon te transferoj aksionet e Shoqërisë Koncesionare "SA-GLE KOMPANI" Sh.p.k te Shoqeria "AG Hpower & Construction" Sh.p.k.

- Berjen e Shoqerise "AG Hpower & Construction" Sh.p.k ortakun e vetem dhe zoterues te 100 % te aksioneve te Shoqërisë Koncesionare "SA-GLE KOMPANI" Sh.p.k.

Pas diskutimeve per rendin e dites dhe menyren e realizimit te transferimit te aksioneve,aksioneret e Shoqërisë Koncesionare "ERNIKU" Sh.p.k

VENDOSI:

- Transferimin e 100% te aksioneve te Shoqërisë Koncesionare "SA-GLE KOMPANI" Sh.p.k nga Shoqerine "ERNIKU" Sh.p.k te Shoqerise "AG Hpower & Construction" Sh.p.k.
- Berjen e Shoqerise "AG Hpower & Construction" Sh.p.k ortakun e vetem te Shoqërisë Koncesionare "SA-GLE KOMPANI" Sh.p.k me zoterim 100% te aksioneve te saje.
- Transferimi te behet sipas Kontrates se Transferimit te hartuar prane nje noteri te dhomes se Noterise Tirane

Shoqëria 'ERNIKU" Shpk

**Ortaku i Vetëm i Shoqërisë:**

ILJAZ SPAHIU

AG HPower & Construction Sh.p.k
Lagja Sheq i Madh,Rruga nacionale Fier-Tirane,
Prane Ures se Mbrostarit,Fier
NIPT: L 91 92 40 26 B

Fier, më 25 / 10 /2021

VENDIM Nr. 07

I Ortakeve të Shoqërisë "AG Hpower & Construction" Sh.p.k

Ky vendim i mare sot më datë 25/10/2021 në selinë e Shoqërisë "AG Hpower & Construction" Sh.p.k, Adresa: Lagja Sheq i Madh,Rruga nacionale Fier-Tirane,Prane Ures se Mbrostarit,Fier, e regjistruar ne Qendren Kombetare te Biznesit me dt. 24/07/2019 me Nipt: L91924026 B ne mblodhjen e Asamblese se Zakonshme e Ortakve te shoqerise.

Në bazë të ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe shoqëritë tregtare", dhe në bazë të Statutit të Shoqërisë, ortaku i shoqërisë thirri Asamblene e Ortakeve me këtë rend dite:

Rendi i ditës:

- Shoqërisë "AG Hpower & Construction" Sh.p.k me ortak te vetem Z.Arben GOGA, zoterus i 100 % te aksioneve te saje.
- Shoqërisë "ERNIKU" Sh.p.k eshte ortak i vetem zoterus i 100 % te aksioneve te Shoqërisë Koncesionare "SA-GLE KOMPANI" Sh.p.k.

Shoqërisë "AG Hpower & Construction" Sh.p.k kerkon te bleje aksionet e Shoqërisë Koncesionare "SA-GLE KOMPANI" Sh.p.k nga Shoqeria "ERNIKU" Sh.p.k.

- Berjen e Shoqerise "AG Hpower & Construction" Sh.p.k ortakun e vetem dhe zoterues te 100 % te aksioneve te Shoqërisë Koncesionare "SA-GLE KOMPANI" Sh.p.k.

Pas diskutimeve per rendin e dites dhe menyren e realizimit te transferimit te aksioneve,aksioneret e Shoqërisë Koncesionare "AG Hpower & Construction" Sh.p.k

VENDOSI:

- Te pranoj blerjen dhe transferimin e 100% te aksioneve te Shoqërisë Koncesionare "SA-GLE KOMPANI" Sh.p.k nga Shoqerine "ERNIKU" Sh.p.k te Shoqerise "AG Hpower & Construction" Sh.p.k.
- Berjen e Shoqerise "AG Hpower & Construction" Sh.p.k ortakun e vetem te Shoqërisë Koncesionare "SA-GLE KOMPANI" Sh.p.k me zoterim 100% te aksioneve te saje.
- Transferimi te behet sipas Kontrates se Transferimit te hartuar prane nje noteri te dhomes se Noterise Tirane.
- Te ngarkohet Administratori i shoqerise Z.Zeni Terpollari te firmosi kontrtaten dhe cdo dokumentacion tjeter qe do te nevojitet per kete transferim te aksioneve.

Ortaku i Vetëm i Shoqërisë

"AG Hpower & Construction" Sh.p.k

Arben GOGA

AG HPOWER & CONSTRUCTION
NIPT: L91924026B

Email:aghpowershpk@gmail.com

Cel: +355 69 60 49 707

"SA-GLE KOMPANI" SH.P.K

NDERTIM, PRODHIM, SHITJE ENERGJI ELEKTRIKE

Tiranë, më 25 / 10 /2021

VENDIM Nr. 12

I Ortakeve të Shoqërisë Koncesionare "SA-GLE KOMPANI" Shpk.

Ky vendim i mare sot më datë 25/10/2021 në selinë e Shoqërisë Koncesionare "SA-GLE KOMPANI" Shpk, Adresa: Sheshi 'Rilindja', Qendra e Biznesit "Karl Topia",Kulla Nr.3, Kati III, Tiranë, regjistruar ne QKB me NIPT K92227019N ne mblodhjen e Asamblese se Zakonshme e Ortakve te shoqerise.

Në bazë të ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe shoqëritë tregtare", dhe në bazë të Statutit të Shoqërisë, ortaku i shoqërisë thirri Asamblene e Ortakeve me këtë rend dite:

Rendi i ditës:

- Shoqërisë Koncesionare "SA-GLE KOMPANI" Sh.p.k me ortak perkatesishte,Shoqerine "ERNIKU" shpk, zoterus i 100 % te aksioneve te saje.

Kerkon te transferoj aksionet e ortakut te vetem me 100 % te aksioneve te saje, Shoqerine "ERNIKU" sh.p.k te Shoqeria "AG Hpower & Construction" Sh.p.k.

- Berjen e Shoqerise "AG Hpower & Construction" Sh.p.k ortakun e vetem dhe zoterues te 100 % te aksioneve te Shoqërisë Koncesionare "SA-GLE KOMPANI" Sh.p.k.

Pas diskutimeve per rendin e dites dhe menyren e realizimit te transferimit te aksioneve,aksioneret e Shoqërisë Koncesionare "SA-GLE KOMPANI" Sh.p.k

VENDOSI:

- Transferimin e 100% te aksioneve te Shoqërisë Koncesionare "SA-GLE KOMPANI" Sh.p.k nga Shoqerine "ERNIKU" Sh.p.k te Shoqerise "AG Hpower & Construction" Sh.p.k.
- Berjen e Shoqerise "AG Hpower & Construction" Sh.p.k ortakun e vetem te Shoqërisë Koncesionare "SA-GLE KOMPANI" Sh.p.k me zoterim 100% te aksioneve te saje.
- Transferimi te behet sipas Kontrates se Transferimit te hartuar prane nje noteri te dhomes se Noterise Tirane.
- Te ngarkohet Administratori i shoqerise Znj.Vera Spahiu te firmosi kontrtaten dhe cdo dokumentacion tjeter qe do te nevojitet per kete transferim te aksioneve.

**Ortaku i Vetëm i Shoqërisë**

Shoqëria "ERNIKU" Shpk

Zoteruesi I 100% te aksioneve

ILJAZ SPAHIU

TIRANA - ALBANIA

Adresa: Sheshi 'Rilindja', Qendra e Biznesit "Karl Topia",Kulla Nr.3, Kati III, Tiranë.
Tel & Fax 04 / 240 36 31, Mob. 068 20 23 775, E-mail: saglekompani@gmail.com



LETËRNJOFTIM ID REPUBLIKA E SHQIPERISE REPUBLIC OF ALBANIA

mbiemri/surname
Tërpollari
emri/given name
Zeni
shtetësia/nationality
Shqiptare/Albanian
vendlindja/place of birth
Çorovodë, ALB
datelindja/date of birth
13-08-1984
data e lëshimit/date of issue
18-12-2019
autoriteti lëshues/authority
MPB
nr.letërnjoftimit/card no.
035364689
gjinia/sex
M
data e skadimit/date of expiry
17-12-2029
nr. personal/personal no.
I40813012F
firma/signature



LETËRNJOFTIM ID REPUBLIKA E SHQIPERISE REPUBLIC OF ALBANIA

mbiemri/surname
Spahiu
emri/given name
Ilijaz
shtetësia/nationality
Shqiptare/Albanian
vendlindja/place of birth
Kolësjan, ALB
datelindja/date of birth
05-07-1969
data e lëshimit/date of issue
03-05-2019
autoriteti lëshues/authority
MPB
nr.letërnjoftimit/card no.
034191858
gjinia/sex
M
data e skadimit/date of expiry
02-05-2029
nr. personal/personal no.
G90705104H
firma/signature

0692023775


REPUBLIKA E SHQIPERISE

Spahiu

Vera

Shqiptare/Albanian

Kruje, ALB

25-06-1974

28-05-2020

MPB

036052618

F

27-05-2030

H45625092N



MINISTRIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK, TURIZMIT, TREGTISË DHE SIPËRMARRJES

OKB

# EKSTRAKT I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT "SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR"

## GJENDJA E REGJISTRIMIT

| | | |
|---|---|---|
| 1. Numri unik i identifikimit te subjektit (NUIS) | K92227019N | |
| 2. Data e Regjistrimit | 27/10/2009 | |
| 3. Emri i Subjektit | SA-GLE KOMPANI | |
| 4. Forma ligjore | SHPK | |
| 5. Data e themelimit | 10/10/2009 | |
| 6. Kohëzgjatja | Nga: 10/10/200910/10/2044 | |
| 7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri | Tirane Tirane TIRANE Sheshi Rilindja, Qendra e Biznesit Karl Topia, Kulla nr. 3, kati i trete | |
| 8. Kapitali | 100.000,00 | |
| 8.1 Numri i përgjithshëm i kuotave | 100,00 | |
| 9. Objekti i aktivitetit | Ndertimi, operimi, financimi,venia ne pune,prodhimi,furnizimi, transmetimi,shperndarja, eksportimi, shitja e energjise elektrike dhe transferim i hidrocentraleve ne zbatim te kontrates se koncensionit date 14.09.2009 "Per ndertimin e hidrocantraleve ne rrjedhen e perroit Trebisht-Rrethi Bulqize te nenshkruar ndermjet "Autoritetit Kontraktor" dhe "Koncesionarit" | |
| 10. Administratori/ët | Vera Spahiu | |
| 10.1 Afati i emërimit | Nga: 08/04/2020 | Deri: 08/04/2025 |
| 11. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore | | |
| 11.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka) | | |
| 12. Ortakët | ERNIKU | |
| 12.1 Vlera e kapitalit | Para: 100.000,00 | Natyre: |
| 12.2 Numri i pjesëve | 100,00 | |
| 12.3 Pjesëmarrja në përqindje (%) | 100,00 | |
| 12.4 Komente (nëse ka) | | |
| 13. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit | Diber TREBISHT TREBISHT Fshati Trebisht, Komuna Trebisht, Rrethi Bulqize | |
| 14. Të dhëna që njoftohen vullnetarisht | Emri Tregtar: SA-GLE KOMPANI<br>E-Mail: fabidici@gmail.com<br>Telefon: 0692023775 | |

Kopje nga web

REPUBLIKA E SHQIPËRISË JULIAN XH. ZHELEGU NOTER TIRANË

MINISTRIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK, TURIZMIT, TREGTISË DHE SIPËRMARRJES

QKB
Qendra Kombëtare e Biznesit
National Business Center

| | |
|---|---|
| 15. Statusi: | Aktiv |

Datë: 09/11/2021

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi
(i nëpunësit të sportelit)

Kopje nga web

Regjistri i Barrëve Siguruese

Rr. e Dibres, Qendra e Biznesit AK,
"Selvia", Kati V
TIRANE, SHQIPERI
TEL/FAX.:355 4 2420005
TEL:355 4 2420006
Email: rbs@roen-al.com

## REZULTATET E KËRKIMIT

### INFORMACION I PËRGJITHSHËM :

| | |
|---|---|
| Numri i Rezultatit të Kërkimit: | D-202111091595303 |
| Data e Rezultatit të Kërkimit: | 09.11.2021 |
| Ora e Rezultatit të Kërkimit: | 3:09:05PM |
| Lloji I Kërkimit: | **Emri i Personit Juridik** |
| Kriteri i Kërkimit: | (EM) SA-GLE KOMPANI SH.P.K. |
| Numri i Dokumentit: | D-400-168-4073 |
| Referenca e Përdoruesit: | |

**NUMRI I REZULTATEVE TE GJETURA SIPAS :**
**(EM) SA-GLE KOMPANI SH.P.K. ËSHTË 1**

*********************** **REGJISTRIMI - A-20160414112842237** ***************************

| | |
|---|---|
| Data e regjistrimit | 14.04.2016 |
| Ora e regjistrimit | 11:28:42AM |
| Kohëzgjatja e Regjistrimit (vite): | 7 |
| Data e Përfundimit të Regjistrimit: | 14.04.2023 |
| Numri i Dokumentit: | A-317-001-9044 |
| Referenca e Përdoruesit: | |

**BARRËMARRËSI (Kreditori):**

| Emri i Personit Fizik/Juridik | Adresa |
|---|---|
| (EM) BANKA CREDINS SH.A. | Adresa: RR. VASO PASHA , NR.8 K31608801O<br>TIRANE-TIRANE<br>SHQIPERI<br>Tel: 04234096<br>Fax: 04222916<br>Email: |

Rr. e Dibres, Qendra e Biznesit AK,
"Selvia", Kati V
TIRANE, SHQIPERI
TEL/FAX:355 4 2420005
TEL:355 4 2420006
Email: rbs@roeo-al.com

**BARRËDHËNËSI (Debitori):**

| Emri i Personit Fizik/Juridik | Adresa |
|---|---|
| (EM) SA-GLE KOMPANI SH.P.K. | Adresa: SHESHI RILINDJA, KULLA 2, K.2<br>K92227019N<br>TIRANE-TIRANE<br>SHQIPERI<br>Tel:<br>Fax:<br>Email: |
| (EM) ILJAZ<br>(AT) EMRI<br>(MB) SPAHIU | Adresa: TIRANE<br>TIRANE-TIRANE<br>SHQIPERI<br>Tel:<br>Fax:<br>Email: |
| (EM) VERA<br>(AT) RAMAZAN<br>(MB) SPAHIU | Adresa: TIRANE<br>TIRANE-TIRANE<br>SHQIPERI<br>Tel:<br>Fax:<br>Email: |

**MALLRA ME NUMER SERIE:**

| Nr. i Serise | Prodhuesi | Viti |
|---|---|---|

**KOLATERAL PERSHKRIM:**

BAZUAR NE MARRVESHJEN SIGURUESE DATE 29.05.2015 BARREDHENESIT VENDOSIN BARRE MBI: KONTRATEN E KONCESIONIT LIDHUR ME DATE 19.09.2009 NR.2901 REP DHE NR.995 KOL. NDERMJET AUTORITETIT KONTRAKTUES METE DHE SHOQERISE KONCESIONARE "ERNIKU" SH.P.K VLERESUAR ME 1.500.000 EURO DHE KUOTAT E SHOQERISE "SA-GLE KOMPANI" SH.P.K NE VLERE 100.000 LEKE.

# Regjistri i Barrëve Siguruese

Rr. e Dibrës, Qendra e Biznesit AK,
"Selvia", Kati V
TIRANE, SHQIPERI
TEL/FAX.:355 4 2420005
TEL:355 4 2420006
Email: rbs@roen-al.com

**PERSONI REGJISTRUES:**

| Emri i Personit Fizik/Juridik | Adresa |
|---|---|
| | Tel:<br>Fax:<br>Email: |

**NËNSHKRIMI I AUTORIZUAR :**

Emri dhe Mbiemri

SIDORELA BRUCI

**FUNDI I REGJISTRIMIT - A-20160414112842237**

REGJISTRI I BARREVE SIGURUESE R.B.S. TIRANË - ALBANIA

Florida Dervishi

Rr. e Dibres, Qendra e Biznesit AK,
"Selvia", Kati V
TIRANE, SHQIPERI
TEL/FAX:355 4 2420005
TEL:355 4 2420006
Email: rbs@roen-al.com

Fundi i Rezultatit të Kërkimit:

Fundi i Dokumentit

REGJISTRI I BARRËVE SIGURUESE TIRANE - ALBANIA

NOTER TIRANE

Flonida Dervishi

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK, TURIZMIT, TREGTISË DHE SIPËRMARRJES

# EKSTRAKT I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT "SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR"

## GJENDJA E REGJISTRIMIT

| | | |
|---|---|---|
| 1. Numri unik i identifikimit te subjektit (NUIS) | J71925004S | |
| 2. Data e Regjistrimit | 23/08/1995 | |
| 3. Emri i Subjektit | ERNIKU | |
| 4. Forma ligjore | SHPK | |
| 5. Data e themelimit | 17/02/1994 | |
| 6. Kohëzgjatja | Nga: 17/02/1994 | |
| 7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri | Tirane Tirane TIRANE Sheshi Rilindja, Qendra e Biznesit Karl Topia, Kulla Nr.3, Kati i Trete | |
| 8. Kapitali | 138.300.000,00 | |
| 8.1 Numri i përgjithshëm i kuotave | 100,00 | |
| 9. Objekti i aktivitetit | Prodhime te lendeve te ndertimit si dhe ndertim te objekteve te ndryshme te ndertimit sipas kerkesave te investitoreve. Import eksport te materialeve te ndryshme te ndertimit me shumice dhe pakice, prodhim te materialeve te ndertimit. Punime dheu, sistemime, tarracime, prodhim elementesh te parafabrikuara betoni e betonarme dhe kompletimi me instalimet e nevojshme per to. Punime elektrike, rivelime topografike, punime topogjeodezike etj Import eksport me shumice dhe pakice te mallrave industriale, ushqimore, bujqesore e blegtorale, veshmbathje e konfeksione etj Hapje e bareve. Restorante, pika servisi parkim automjetesh, lavazhi etj | |
| 10. Administratori/ët | Iljaz Spahiu | |
| 10.1 Afati i emërimit | Nga: 30/09/2021 | Deri: 29/09/2026 |
| 11. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore | | |
| 11.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka) | | |
| 12. Ortakët | IljazSpahiu | |
| 12.1 Vlera e kapitalit | Para: 138.300.000,00 | Natyre: |
| 12.2 Numri i pjesëve | 100,00 | |
| 12.3 Pjesëmarrja në përqindje (%) | 100,00 | |
| | | |

Kopje nga web

OKB

| | |
|---|---|
| *- Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse zotëron kuotën si përfaqësues)* | |
| 13. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit | Tirane Tirane TIRANE Automjet Mercedes Benz me targe TR 6813 R, Terheqes Tirane Tirane TIRANE Automjet Man me targe TR 7657 E, Kamion Tirane Tirane TIRANE Automjet Cargotrailers me targe TR 6784 R, Gjysemrimorkio Tirane Tirane TIRANE Automjet Mercedes Benz me targe TR 1197 T, Kamion Tirane Tirane TIRANE Automjet Cargotrailers me targe TR 6814 R, Gjysemrimorkio Tirane Tirane TIRANE Automjet Mercedes Benz me targe TR 1936 T, Kamion Tirane Tirane TIRANE Automjet Mercedes Benz me targe TR 3186 S, Kamion Tirane Tirane TIRANE Automjet Vidal me targe TR 0122 M, Gjysemrimorkio Tirane Tirane TIRANE Automjet Mercedes Benz me targe AA 286 CL, Kamion Tirane Tirane TIRANE Automjet Scania me targe TR 9117 R, Autovinxh Lezhe Mamurras GJORM Bashkia Mamurras, Fshati Gjorm Tirane Tirane TIRANE Automjet Mercedes Benz me targe TR 4753 P, Kamion+Betoniere Tirane Tirane TIRANE Automjet Mercedes Benz me targe TR 6783 R, Terheqes Tirane Tirane TIRANE Automjet Man me targe TR 9094 L, Terheqes Tirane Tirane TIRANE Automjet Astra me targe TR 1759 T, Kamion Tirane Tirane TIRANE Automjet Iveco Magirus me targe TR 8314 N, Terheqes Tirane Tirane TIRANE Automjet Iveco Magirus me targe TR 5617 P, Kamion Tirane Tirane TIRANE Automjet Mercedes Benz me targe TR 9461 N, Bot nafte-atv Tirane Tirane TIRANE Automjet Astra me targe TR 8814 T, Kamion Tirane Tirane TIRANE Automjet Man me targe TR 9095 L, Gjysemrimorkio Tirane Tirane TIRANE Automjet Piacenza me targe TR 7830 P, Bot cimento Tirane Tirane TIRANE Automjet Bianchi me targe TR 8315 N, Gjysemrimorkio Tirane Tirane TIRANE Automjet Fiat me targe TR 9831 M, Autobitumatrice Tirane Tirane TIRANE Automjet Astra me targe TR 8826 N, Atv-autobetoniere Tirane Tirane TIRANE Automjet Astra me targe TR 1339 M, Apv-pomp betonit Tirane Tirane TIRANE Automjet Astra me targe TR 2145 M, Atv-betoniere |
| 14. Të dhëna që njoftohen vullnetarisht | Emri Tregtar: ERNIKU<br>Telefon: 2220541<br>Të Tjera: Depozitimin e vendimit nr. 7 date 26.07.2008 per miratimin e llogarive vjetore dhe percaktimin e fitimit. Caktohet Ekspert Kontabel i Autorizimi z. Leonidha Foti me license Nr. 150, date 08.06.2006 per zmadhimin e Kapitalit Themeltare.Ne cn-442404-09-10 u depozitua vendimi i ortakut te vetem date 30.08.2010 per caktimin e ekspertit |

Kopje Web

| | |
|---|---|
| | kontabel te regjistruar shoqerine "Financial Consulting Studio K&L" me nr regjistri 168 per zmadhimin e kapitalit. |
| 15. Statusi: | Aktiv |

Datë: 09/11/2021

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi
(i nëpunësit të sportelit)

Kopje nga web

REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK, TURIZMIT, TREGTISË DHE SIPËRMARRJES

QKB

# EKSTRAKT I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT "SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR"

## GJENDJA E REGJISTRIMIT

| | |
|---|---|
| 1. Numri unik i identifikimit te subjektit (NUIS) | L91924026B |
| 2. Data e Regjistrimit | 24/07/2019 |
| 3. Emri i Subjektit | AG Hpower & Construction |
| 4. Forma ligjore | SHPK |
| 5. Data e themelimit | 23/07/2019 |
| 6. Kohëzgjatja | Nga: 23/07/2019 |
| 7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri | Fier Fier FIER Lagja Sheq i Madh, Rruga nacionale Fier - Tirane, Prane Ures se Mbrostarit, Fier. |
| 8. Kapitali | 100.000,00 |
| 8.1 Numri i përgjithshëm i kuotave | 1,00 |
| 9. Objekti i aktivitetit | Studim projektim e ndertim i ndertesave civile e industriale, rrugeve, tuneleve, urave mbi dhe nen kalimeve, autostradave, traseve hekurudhore, digave dhe veprave hidroteknike bonifikuese ose vaditese, uiesiellsave, kanalizimeve te uirave te bardha e te zeza, linjave mbi dhe nentokesore te energiise dhe telekomunukacionit, centraleve dhe hidrocentraleve, rrjeteve inxhinjerike, porteve dhe aeroporteve. Prodhim dhe Tregtim te Energiise Elektrike. Prodhimin dhe tregetimin e materialeve te ndertimit, betonit dhe asfaltit, importin dhe eksportin. Kerkimin, nxierrjen, perpunimin, tregetimin dhe import eksportin dhe cdo veprimtari qe lidhet me burimet dhe resurset natyrore.Me qellim kryerjen e aktiviteteve te mesiperme, shoqeria mund te ushtroje veprimtarine e saj ne Shqiperi dhe jashte saj e te kryeje çdo aktivitet tjeter te lidhur, ndihmes, te ngjashem, plotesues apo te dobishem per permbushjen e objektit te saj. Per permbushjen e objektit te saj, Shoqeria mund te: Te zoteroje direkt ose indirekt pjesemarrje ne shoqeri dhe/ose sipermarrje te tjera, shqiptare apo te huaja, qe kryejne aktivitete te njejta, te ngjashme apo te lidhura me aktivitetin e saj ose qe mund te ndihmojne ne realizimin e objektit te Shoqerise; Te kryeje çdo aktivitet e transaksion tregtar, ne lidhje me pasuri te luajtshme e te paluajtshme; Te jape dorezani, hipoteka, garanci reale dhe/ose personale; Te themeloje dege, zyra perfaqesimi dhe ne pergjithesi te kryeje çdo aktivitet tjeter qe nuk eshte i |

Kopje nga web

MINISTRIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK, TURIZMIT, TREGTISË DHE SIPËRMARRJES

QKB

| | | |
|---|---|---|
| | ndaluar nga ligji. | |
| 10. Administratori/ët | Zeni Tërpollari | |
| 10.1 Afati i emërimit | Nga: 23/07/2019 | Deri: 23/07/2024 |
| 11. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore | | |
| 11.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka) | | |
| 12. Ortakët | ArbenGoga | |
| 12.1 Vlera e kapitalit | Para: 100.000,00 | Natyre: |
| 12.2 Numri i pjesëve | 1,00 | |
| 12.3 Pjesëmarrja në përqindje (%) | 100,00 | |
| *- Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse zotëron kuotën si përfaqësues)* | | |
| 13. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit | | |
| 14. Të dhëna që njoftohen vullnetarisht | Emri Tregtar: AG Hpower & Construction<br>E-Mail: aghpowershpk@gmail.com<br>Telefon: +355 69 60 49 707 | |
| 15. Statusi: | Aktiv | |

Datë: 09/11/2021

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi
(i nëpunësit të sportelit)

Kopje nga web